



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 320/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesë dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Nisma Qytetare për Prizren (NQP) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren kështu që subjektit politik Nisma Qytetare për Prizren (NQP), dega në Prizren i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 23.10.2013, subjekti politik LDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 17 tetorë 2013, në ora 09:30, në rrugën kryesore të qytetit, përbal qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare, militantët e subjektit politik NQP me vetëdije të plotë dhe me qëllim, në kundërshtim me nenin 33, pika a) e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në kundërshtim me nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 3 pika 3.1 të Rregullorës me nr. 01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave kanë dëmtuar dhe mbuluar posterët e LDK-së, mbi të cilat kanë vendosur posterat e kandidatit të PDK-së për Kuvendin Komunal. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik NQP, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik NQP, lidhur me ankesën Anr 320/2013, ku e ka kundërshtuar ankesën e subjektit politik LDK si te pa bazë dhe për më tepër të manipuluar qëllimisht. Më tutje ka theksuar se, në vendin ku përmend ankuesi, NQP-ja nuk e ka vënë asnjë posterë të z.Islam Bajrami, sepse ai vend për ne është shembull i manipulimit të pushtetit, pikërisht nga LDK-ja .Për më tepër ka shtuar se, në vendin e potencuar shihet sajimi i çartë se si e kanë ngjitur posterin e Islam Bajramit, e kanë fotografuar dhe më pas e kanë hudhur në tokë .

Në përgjigje në ankesë subjekti politik NQP, ka ofruar provë si fotografinë e vendit të ngjarjes si dëshmi, si dhe deklaratat e personave në cilësinë e dëshmitarit, me të cilat i mbështesin kundërshtimet ndaj pretendimeve ankimore .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se si posterat e subjektit politik LDK janë dëmtuar dhe mbuluar me posterat e subjektit politik NQP, gjë që e bënë përgjegjës subjektin politik NQP , veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika a) të LZP-së te cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. që ndalon mbulimin e posterave nga një subjekt tjetër politik.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i morri parasysh të gjitha rr Ethanat si rënduese ashtu edhe lehtësuese. Si rr Ethanë rënduese morri se subjekti politik NQP pas marries së përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarrë veprime të dukshme, duke e larguar posterin e vendosur ne vendin ku pretendohet se ka ndodhur shleja .

Andaj duke marrë parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstatoi se subjekti politik NQP, në këtë rast ka thyer Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118. 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 320/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatë (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e larië sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.